

**STATUTI DHE AKTI THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJESI TE KUFIZUAR
BLENDI GROUP SHPK**

Sot ne date 05 / 04 / 2024, me cilesine e "Ortakeve themelues":

Z. Blend Rama, atesia Shaip, i datëlindjes 07.07.1990, lindur ne Prishtine Kosove dhe banues ne Gustav Mayer 13, Prishtine, Kosove, shtetas Kosovar, me nr. personal 1171281861 mbajtës i Pashaportes me Nr. P02127660.

me vullnet të lire, të plote dhe të sinqerte, ka hartuar këtë statut te Shoqerise "**Blendi Group**" shpk , ne respekt dhe bazuar:

- Ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi;
- Ne ligjin 9901 date 14.04.2008, " Per tregtaret dhe Shoqerite tregtare ";
- Ne ligjin " Per Qendren Kombetare te Regjistrimit ";
- Ne legjislacionin Fiskal e Tatimor;

ka themeluar nje Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emertimin "**Blendi Group**".

**Neni 1
Emertimi**

Shoqeria gezon emerin **Blendi Group shpk** dhe eshte person juridik i te drejtes shqiptare, shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria").

**Neni 2
Selia**

Shoqeria e ka seline ne Durres, Lagja nr.13, zona kadastrale 8518 nr. pasurie 58/101/ND+1-14, shk.1 Ap. nr. 14. Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, me kerkese te administratorit ose me vendim te Ortakeve.

**Neni 3
Kohezgjatja**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të papërcaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit. Vendosja e mëpasshme e një kufizimi në kohe është kompetence e mbledhjes se asamblesë se Ortakeve te Shoqërisë.

**Neni 4
Objekti i veprimtarise**

05.04.2024

BR



Objekti i veprimtarise se Shoqerise do te jete:

Aktivitetete të tjera publikimi. Shërbime të para-shtypshkrimit dhe para-komunikimit. Lberlidhja dhe shërbime të lidhura me to. Publikimi i librave. Aktivitetete të tjera publikimi. Shërbime të tjera të teknologjisë së informacionit. Aktivitetete të marrdhënieve publike dhe të komunikimit. Organizatorë të konferencave dhe panaireve. Tregtia me shumicë e tekstileve. Tregtia me shumicë e kompjuterave, pajisjeve periferike të kompjuterave dhe programeve. Tregtia me shumicë pajisjeve elektronike dhe të telekomunikacionit dhe pjesëve të tyre. Tregtia me shumicë e makinerive dhe pajisjeve të tjera të zyrës. Tregtia me shumicë e makinerive, pajisjeve dhe pjesëve. Tregtia me shumicë jo e specializuar. Tregtia me pakicë e mobiljeve, pajisjeve të ndriçimit dhe artikujve shtëpiakë në dyqane të specializuara. Tregtia me pakicë e gazetave dhe artikuj shkrimorë në dyqane të specializuara. Tregtia me pakicë e pajisjeve sportive në dyqane të specializuara.

Neni 5

Kapitali themeltar

Kapitali Themeltar i Shoqerise eshte 100'000 (njqindmije) leke i ndare ne 1 (nje) kuote, vlere e te ciles zoterohet nga Ortaket si me poshte:

- **Z. Blend Rama**, zoterues i 1 (nje) kuote, e cila perfaqeson 100 % te kapitalit me vleren 100'000 (njqindmije) leke.

Neni 6

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i Shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të Kapitalit Themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë apo financime ne cash, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute ne natyre sipas kërkesës së administratorit.

Zvogëlimi i kapitalit realizohet me vendim te Ortakeve në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin te nenit perkates te statutit, kapitali fillesatar eshte i pataksueshem. Projekti i zvogëlimit të kapitalit u komunikohet ekspertëve kontabël të autorizuar, në rast se ka të tillë, të paktën 45 ditë përpara datës së mbledhjes së Asamblese se Ortakeve thirrur për të marrë vendim rreth këtij projekti.

Zvogëlimi i kapitalit themeltar në një vlerë më të vogël se ajo e përcaktuar në nenin 6 te ketij statuti, e bën të detyrueshme marrjen e një vendimi prej Shoqërisë për zmadhimin e kapitalit themeltar të paktën deri në vlerën minimale. Në rast moszbatimi të kërkesave të këtij paragarfi, çdo personi interesuar mund të kërkojë në rrugë gjyqësore prishjen e Shoqërisë. Kjo prishje nuk mund të shpallet, në qoftë se rregullimi është bërë në ditën kur gjykata mblidhet për të marrë vendim.

Neni 7

Transferimi i kapitalit ndermjet Ortakeve apo ne persona te trete

Kuotat e kapitalit të një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e Shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim e nenshkuar



personalisht nga dhe vetem prej Ortakut perfaqshues apo personit te prokuruar prej tij. Kuotat per shitje i propozohen me pare repektivisht Ortakeve te Shoqerise per nje afat 30 dite, pas kalimit te ketij afati ato jane lirisht te transferueshme ndaj cdo personi te interesuar. Personi qe kalon kuotën dhe ai qe e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj Shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave deri në çastin e regjistrimit të kalimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”. Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Neni 8 Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i Shoqerise. Asambleja e Ortakeve eshte organi vendimmarres i Shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj. Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasyqruar ndryshimet ne skeden e Shoqerise.

Asambleja e Ortakeve, vendos dhe pergjigjet për çështje si :

- përcaktimi i politikave tregtare të Shoqërisë;
- emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- përcaktimin e shpërblimeve
- mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve periodike të ecurisë së veprimtarisë;
- përfaqësimin e Shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Të gjitha vendimet e marra nga Asambleja e Ortakeve regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- investime, transferime kuotash, etj;
- vendimet për riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë.

Vendimet e parregjistruara në regjistrin e vendimeve apo te papublikuara ne regjistrin tregtar ne QKR, janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur Shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 9 Mbledhjet e asamblese se Ortakeve

Nëse nuk përcaktohet një vend tjetër, Asambleja e Ortakeve i mban mbledhjet e saj në selinë e Shoqërisë.

Mbledhjet e Asamblese se Ortakeve do të mbahen jo më pak se 2 (dy) herë në vit, ose mbledhja pasardhëse e Asamblese se Ortakeve do të jetë me një distancë kohore jo më vonë se 6 (gjashte) muaj nga mbledhja paraardhëse.

Çështjet që kërkojnë miratimin e Asamblese se Ortakeve mund të komunikohen me poste te zakonshme apo edhe me poste elektronike (email) dhe keto komunikime jane te vlefshme kur konfirmohen dhe nenshkruhen nga Ortaket, anetare te Asamblese.



Thirrja dhe vendimet e Asamblese se Ortakeve janë të vlefshme kur procedurat kryhen ne perputhje me Ligjin e Shoqerive Tregtare. Nëse, si rrjedhim i thirrjes se pare te Asamblese, nuk realizohet kuorumi nevojshem, mbledhja e Asamblese do të shtyhet për një datë te dyte ne distance kohore prej 10 ditesh nga e para dhe, ne rast se edhe ne kete mbledhje te dyte mungon vendimmarrja, Ortaket pranojne vleresimin e kuotave (cmimin per shitje) brenda nje afati prej 7 ditesh dhe me pas ofrojne kalimin e tyre midis njeri-tjetrit, sikurse eshte theksuar ne Nenin 7 ketu, me nje afat brenda 30-ditesh. Pas kalimit te afatit prej 37 ditesh kuotat behen lirisht te transferueshme per shitje kundrejt cdo personi te interesuar per to.

Njoftimi per thirrjen e mbledhjes se Asamblese dhe materialet per diskutim, nisen me poste fizike (poste te zakonshme) ose elektronike, minimumi 7 dite para dates kur do zhvillohet mbledhja e radhes. Kur te gjithe Ortaket jane dakort, mbledhja mund te zhvillohet ne cdo date. Ortaket, me vendim Asambleje, depozitohen prane Shoqerise adresat e postes elektronike ku duan te marrin dhe nga ku do tu pergjigjen komunikimeve te Shoqerise. Ndryshimet e adreses se postes elektronike duhet ti komunikohen Administratorit te Shoqerise me poste fizike, me leter rekomandë ose me poste elektronike dhe deri kur komunikimi per ndryshimin e adreses elektronike nuk ka mberitur do konsiderohet e vlefshme adresa egzistente ne arkivat e Shoqerise.

Neni 10 Administrimi

Emërimi i Administratorit të Shoqërisë është kompetencë e Asamblese se Ortakeve. Administrator i Shoqerise emerohet për një afat 5 (pese) vjet me të drejtë riemërimi dhe do të jetë ortaku vijues:

- **Z. Blend Rama**, atesia Shaip, i datëlindjes 07.07.1990, lindur ne Prishtine Kosove dhe banues ne Gustav Mayer 13, Prishtine, Kosove, shtetas Kosovar, me nr. personal 1171281861 mbajtës i Pashaportes me Nr. P02127660.

Administratori ka kompetenca, mban pergjegjesi dhe ka per detyre:

Administratoret mund te veprojne bashkarisht ose veç e veç ne lidhjen e kontratave, hapjen e mbylljen e llogarive bankare si edhe kryerjen e veprimeve te ndryshme bankare, perfaqesimin e shoqerise me pale te treta e me institucionet Shteterore, lokale dhe qendrore, kryerjen e transakcioneve ekonomike, qofshin keto per aktivitetin operativ si edhe ate investues.

Neni 11 Inventari, Pasqyrat dhe Viti Financiar

Viti financiar fillon në ditën e parë të Janarit dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti. Përrjashtimisht, viti i parë financiar do të fillojë në datën kur Shoqëria është regjistruar dhe mbaron më 31 Dhjetor të të njëjtit vit.

Në përfundim të çdo viti financiar, administratori përgatit inventarët, pasqyrat financiare dhe raportin gjithëvjeter të administrimit, në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi mbi kontabilitetin. Po ne vijim Administratori dhe konsulentet financiar, qe kontraktohen nga Shoqeria, pasqyrojne ne analize shpenzimet dhe risqet fiskale, planifikojne buxhetet vjetore dhe i propozojne Asamblese se Ortakeve politika per te ardhmen e Shoqerise.

Fitimi neto i realizuar që ka rezultuar pas zbritjes së shpenzimeve si dhe vlerës së fondit rezervë, u kalon Ortakeve në përputhje me përqindjen e kontributit të tyre në Kapitalin Themeltar të Shoqërisë ose mund të kalojë për investime, por gjithmone bazuar ne një vendim të shkruar te Asamblesë së Ortakeve.



Bartja afatgjate e detyrimeve financiare te Shoqerise kundrejt te treteve, institucione bankare apo individeve, ndalon Asamblene e Ortakeve ne ndarjen e dividenteve me prioritet permirsimin e gjendjes financiare te Shoqerise dhe rritje te pergjegjesise dhe perparsise per fondet qe Shoqeria mobilizon per aktivitetin e saj tregtar kundrejt te treteve duke i dhene perparesi ketyre te fundit.

Mbledhja e Asamblesë së Ortakeve ka te drejte dhe mund të krijojë edhe lloje të tjera fondesh, apo rezervash përveç fondeve të parashikuara këtu.

Neni 12
Baza ligjore


Shoqeria do te zhvillje aktivitetin ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjiskacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit civil dhe cfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Shoqëria **Blendi Group shpk**

ORTAKU I VETEM

Z. BLEND RAMA



BR

05.04.2024

PROKURE

Emeroj si perfaqesues te posacem z. Jurild Hoxha me nr. personal I90929101T te me perfaqesoje prane **Qendres Kombetare te Biznesit** ne sportel ose online nepermjet e Albania per te kryer cdo procedure per rregjistrim te dhenash dhe ndryshime te tyre sipas procedurave e kerkesave ligjore dhe kerkesave e vendimeve te shoqerise.

Kjo prokure e posacme eshte e vlefshme nga momenti i nenshkrimit te saj dhe per nje kohe te pacaktuar, me te drejten e revokimit te saj ne cdo kohe.

I perfaqesuari deklaron se: "Te gjitha veprimet e kryera nga perfaqesuesi im i posacem brenda tagrave te percaktuara ne kete prokure, do ti konsideroj te drejta dhe te mireqena sikur te ishin kryer prej meje".

05.04.2024

BLEND RAMA

Nr. Personal: 1171281861



LRP nr. 2787/2024

-----VËRTETIM I NËNSHKRIMIT-----

Astrit S. Bibaj, Noter në Prishtinë, rruga: "Garibaldi" nr. 15/5, vërteton se:-----
Nënshkrimi i vendosur në faqen tjetër të dokumentit të quajtur: "**PROKURE**" është bërë
në praninë e noterit nga:-----

z. BLEND RAMA, i lindur më: **07/07/1990** (shtatë korrik një mijë e nëntëqind e
nëntëdhjetë) në: **Prishtinë**, shtetas i Republikës së Kosovës, bartës i dokumentit të
identifikimit me nr. personal: **1171281861**, të lëshuar nga MPB e Republikës së
Kosovës, me vendbanim sipas pohimit në: Prishtinë -----

Noteri nuk përgjigjet për përmbajtjen e dokumentit, noteri vetëm vërteton se nënshkrimi
i: **z. BLEND RAMA**, është vënë në faqen tjetër të dokumentit në praninë e tij dhe në
zyrën e tij.-----

Për vërtetimin e nënshkrimit në këtë dokument është paguar kompensimi në shumën nga
1 (një) euro për nënshkrim, + TVSH, konform nenit 31.1 të U.A. 05/2022 për Tarifat
Noteriale.-----

Dokumenti i sjell nga pala ka 1 (një) fletë dhe është shënuar në pjesën e përparme të tij,
Dokumenti është vërtetuar në një kopje identike, dhe vërtetohet se nënshkrimi i vendosur
në faqen tjetër të dokumentit është bërë në praninë e noterit me datë: pesë prill dymijë e
njëzet e katër **(05.04.2024) h 09:55**-----

Noteri



Astrit S. Bibaj

